



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

Shtojca 11.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data: 15.07.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE) WOODPECKER me NIPT L23109601T ,
Adresa: Shkoder Shkoder BOKS Boks-Shkoder, Nr pasurie 553/8, zona kadastrale 1240 4001.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) PO ☐ JO X

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: “E hapur”, mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-87460-05-26-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje dru zjarri dhe pelet”

Fondi limit: 74,999,998 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe 785,547.06 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë pikë zero gjashtë) Euro pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 28.05.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : *Buletini Nr.35 Datë 01 Qershor 2026.*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. (OE) DAFINOR me NIPT K16729001N

Vlera: 74,269,800 (*Shtatëdhjetë e katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind*) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. (OE)WOODPECKER me NIPT L23109601T

Vlera: 73,982,826 (*Shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë*) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. (OE) DAFINOR me NIPT K16729001N

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik DAFINOR sh.p.k., konstatoi se oferta nuk përmbush kërkesat e Dokumenteve të Tenderit për arsyet si më poshtë:

1. Mospërmbushja e pikës 2.3.11 të Dokumenteve të Tenderit

Në pikën 2.3.11 të Dokumenteve të Tenderit përcaktohet se:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) në ditën e hapjes së ofertave.

Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se operatori ekonomik DAFINOR sh.p.k. nuk ka dorëzuar mostrat e kërkuara.

Mosparaqitja e mostrave përbën mosplotësim të një kërkesë të detyrueshme të Dokumenteve të Tenderit dhe nuk mund të plotësohet pas afatit të dorëzimit të ofertave.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.11 të Dokumenteve të Tenderit.

2. Mosparaqitja e certifikatave ISO

Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vetëm certifikatën ISO 9001:2015, ndërsa nuk ka paraqitur certifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, të kërkuara nga Dokumentet e Tenderit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat e Dokumenteve të Tenderit lidhur me certifikimet e kërkuara.

3. Mospërmbushja e pikës 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit

Në pikën 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën dhe burimin e ligjshëm të mallrave objekt prokurimi, nëpërmjet kontratave të furnizimit, lejeve të shfrytëzimit të pyllit, faturave tatimore ose dokumentacionit të importit, sipas rastit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik DAFINOR sh.p.k. rezulton se është paraqitur kontratë furnizimi me subjektin DURAKU-A sh.p.k., së bashku me dokumentacionin përkatës, i cili provon origjinën dhe burimin e ligjshëm vetëm për dru Ah 1000m3.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik DAFINOR sh.p.k.:

- nuk ka dorëzuar mostrat sipas pikës 2.3.11 të Dokumenteve të Tenderit;*
- nuk ka paraqitur certifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, të kërkuara nga Dokumentet e Tenderit;*
- nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë që provon origjinën dhe burimin e ligjshëm të mallrave objekt prokurimi, në kundërshtim me kërkesën e pikës 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit.*

Për rrjedhojë, oferta e operatorit ekonomik DAFINOR sh.p.k. nuk përmbush kërkesat e Dokumenteve të Tenderit dhe nuk kualifikohet për fazat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **(OE) WOODPECKER** me NIPT **L23109601T** , Adresa: Shkoder Shkoder BOKS Boks-Shkoder,Nr pasurie 553/8, zona kadastrale 1240 4001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 73,982,826 *(Shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë)* Lekë pa TVSH dhe 88,779,391.20 *(Tetëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një)* Lekë me TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar